

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“UNGJILLËZIMI” Sh.p.k.**

Sot më datë 17.03.2022, në Tiranë, Ortaku Themelues:

**Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë**, person juridik, regjistruar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Nr. 2498, datë 19.03.2009, me seli Rruga e Kavajës, nr. 151 Tiranë, përfaqësuar nga Venian Mile, lindur në Korë me dt.28.025.1976 dhe banues në Tiranë, sipas Prokurës së Posaçme Nr.436Rep, Nr.273Kol, dt.15.03,2022 të noterit E. Kokoli nga Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Anastasios Yannulatos,

e cila ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë “Shoqëria”), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

**Neni 1 - Emërtimi**

1.1. Emërtimi i Shoqërisë është **“UNGJILLËZIMI” Sh.p.k.**

**Neni 2 - Selia**

2.1 Selia e Shoqërisë është në Rr. “Dibrës”, Nd. 110H7, Tiranë, Shqipëri. Selia është e transferueshme. Shoqëria mund të hapë në të ardhmen degë apo përfaqësi të saj në adresa të tjera në Tiranë apo qytete të tjera.

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

3.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë do të jetë me një afat të pacaktuar.

**Neni 4 – Objekti i shoqërisë**

- 4.1 Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 4.2 Në mënyrë më specifike, Shoqëria do të mund të kryejë çdo aktivitet të ligjshëm tregtar, që lidhet me hapjen dhe menaxhimin e farmacive me qëllim tregtimin me pakicë të produkteve farmaceutike, kozmetike, bimëve mjekësore, instrumenteve dhe pajisjeve shëndetsore dhe mjekësore, sanitare, shtesa ushqimore etj.

**Neni 5 – Kapitali themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind) lekë.
- 5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 100 (njëqind) lekë.

**Neni 6 - Kontributet**

6.1. Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar në masën 100% nga ortaku i vetëm themelues.

**Neni 7 – Transferimi i kuotave**

7.1 Kuotat janë të transferueshme në favor të të tretëve të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.



### Neni 8 – Administrimi

- 8.1 Me këtë akt emërohet Administrator i Shoqërisë personi si më mëposhtë:
- Elda BUÇKA, e bija e Agronit, lindur në Tiranë me dt.27.04.1991 dhe banuese në Tiranë, identifikuar me Nr. Personal J15427084C. Kohëzgjatja e mandatit është 5 vjet nga data e regjistrimit të Shoqërisë në QKB me të drejtë riemërimi.
- 8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” dhe nenit 14 të Statutit.
- 8.3 Administratori është i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë, përveç veprimeve që ligji i njej Asamblesë së Përgjithshme/ Ortakut të Vetëm si edhe ka të drejtë t’u delegojë kompetencat e tij personave të tjerë. Veprimet e administratorit kryhen gjithmonë në interes të Shoqërisë dhe janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj. Administratori është përgjegjës për veprimet e tij para Shoqërisë dhe të tretëve për çdo shkelje të ligjit apo Statutit apo për veprime me faj të kryera gjatë administrimit.

### Neni 9– Gjuha

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) origjinale në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet rregullisht nga përfaqësuesi i Ortakut të Vetëm.

### ORTAKU I VETËM

#### Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë

Përfaqësuar me Prokurë nga Venian Mile

